



Elektrodistribucija DOOEL është kompani, veprimtaria kryesore e së cilës është shpërndarja dhe furnizimi me energji elektrike në Republikën e Maqedonisë Veriore. Kompanija është pjesë e grupacionit EVN

KARRIERË NË ELEKTRODISTRIBUCIJA

Për nevojat e Departamentit të matjes dhe MDM, në grupën Sistemet e njehsorëve me komunikim lokal kërkojmë:

LEXUES TË NJEHSORËVE (M / F) me kohë të caktuar (12 muaj) me vend pune në Shkup, Tetovë, Shtip, Koçan

Detyrat e punës:

- Leximi i njehsorëve në terren, duke shënuar gjendjen e saktë të energjisë elektrike të konsumuar,
- Përshkrimi dhe shënimi i saktë i parregullsive nga pika matëse përmes futjes së duhur të kodeve
- Raportimi i dyshimit për manipulim me njehsorët
- Kujdes dhe përgjegjësi për punën e përcaktuar dhe pajisje teknike për leximin e njehsorëve
- Mirëmbajtja e pajisjeve teknike funksionale dhe korrekte për leximin e njehsorëve
- Dorëzimi i informacioneve për gjendjen e njehsorëve dhe pikave matëse
- Komunikimi i sjellshëm me konsumatorët

Kompetencat e nevojshme

- Arsimi i mesëm
- Saktësia
- Besnikëri, fleksibilitet dhe përgjegjësi
- Gatishmëria për të udhëtuar
- Puna ekipore dhe komunikimi

Nëse jeni të interesuar për karrierë në Elektrodistribucija dërgoni biografinë tuaj të shkurtër në jobs.elektrodistribucija@evn.mk më së voni deri më **20.05.2022**.

Vërejtje: Në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke paraqitur aplikacionin tuaj, ju pranoni që të dhënat tuaja të ruhen, përpunohen dhe përdoren ekskluzivisht për qëllime rekrutimi dhe përzgjedhjeje. Më shumë informacion për të drejtat tuaja për përpunimin e të dhënave, si dhe për mënyrën e përpunimit të të dhënave mund të gjeni në linkun e mëposhtëm <https://www.evn.mk/Careers.aspx>.

Elektrodistribucija është kompani e cila ofron mundësi të barabarta dhe tretman të drejtë gjatë punësimit të të gjithë personave pavarësisht racës, gjinisë, religjionit, përkatësisë nacionale, llojit të aftësisë së kufizuar ose përkatësisë politike.